

Nis rikonstrukcioni i Spitalit Infektiv



Ka nisur zbatimin e projektit madhor për rehabilitimin e plotë dhe zgjerimin e kapaciteteve të Spitalit Infektiv në QSUT. Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Ogerta Manastirliu, ka inspektuar fillimin e punimeve, ku bëri me dije se rikonstrukcioni i Spitalit Infektiv do të organizojë dhe modernizojë shërbimin, sipas standardeve më të mira për trajtimin e pacientëve, duke e kthyer këtë spital në një qendër referencë në vend për trajtimin e sëmundjeve infektive. Kapaciteti i plotë i këtij spitali do të jetë 118 shtretër. Projekti parashikon dyfishim të kapaciteteve të reanimacionit dhe shtim të kapaciteteve do të ketë dhe në repartin e urgjencës.

PAKETAT SHËNDETËSORE FALAS

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale garanton paketën e implanitit koklear falas për fëmijët me humbje të thellë dëgjimi. Ministrja Ogerta Manastirliu ka vizituar në QSUT fëmijët që i janë nënshtuar procedurës së implanitit koklear, për rikuperimin e dëgjimit. Deri tani janë kryer 20 procedura të kësaj ndërhyrjeje delikate, teksa do të vijojë financimi i procedurës së kushtueshme për fëmijët e lindur me humbje të thellë dëgjimi.



VIJOJNË PUNIMET NË PEDIATRINË INFEKTIVE NË QSUT

Pas ndërtimit të Pediatriisë së re në QSUT për shërbimin e urgjencës, reanimacionit dhe kirurgjisë, ka nisur puna për rehabilitimin e një tjetër godine të shërbimit pediatrik, Pediatriisë Infektive, e cila u dëmtua nga tërmeti i 26 Nëntorit. Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu ka inspektuar punimet që po kryhen për rehabilitimin e kësaj godine, ku theksoi se do të vijojë puna për përfundimin e plotë të projektit madhor të Pediatriisë së QSUT. Investimi në kompleksin pediatrik në QSUT do të vijojë edhe me rehabilitimin e godinës ekzistuese dhe në total për dy fazat e projektit, vlera e financimit është 15 milion euro.

BLLOKU I RI KIRURGJIKAL NË SPITALIN RAJONAL SHKODËR

Spitali Rajonal i Shkodrës ka tashmë një bllok të ri operator, falë investimit të qeverisë shqiptare në vlerën 1 milion dollarë. Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu ka parë nga afër bllokun e ri operator, ku me investimin e ri, kryhet një gamë e larmishme e ndërhyrjeve kirurgjikale, duke e përafuar këtë spital rajonal me qendrat më të mëdha universitare të Tiranës.



DY VJET NGA PANDEMIA COVID-19 NË SHQIPËRI

Në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është organizuar një aktivitet në kuadër të dy vjetorit të fillimit të pandemisë në Shqipëri, me praninë e ekspertëve dhe mjekëve që kanë kontribuar në këto dy vite për përballimin e situatës. Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Ogerta Manastirliu, ka shprehur mirënjohjen për të gjithë ekipet mjekësore në strukturat shëndetësore. Në këto dy vite janë 771 mjekë që u angazhuan në vijën e parë, 1936 infermierë, laborantë e farmacistë, 134 epidemiologë dhe 979 staf mbështetës. 4 laboratorë publikë kanë shërbyer për testim dhe janë krijuar 230 pika testimi në komunitet për gjurmimin kapjen e hershme dhe izolimin e rasteve covid. Në spitale u forcuan kapacitetet me 550 shtretër në 4 spitale Covid në Tiranë dhe në total 1600 shtretër të pajisur në spitalet rajonale duke siguruar dyfishimin e kapaciteteve në terapinë intensive. Deri tani janë siguruar nga qeveria shqiptare 5 milion doza vaksine antiCOVID.

MANASTIRLIU MERR PJESË NË SESIONIN E 66 TË KOMISIONIT TË GRUAS NË OKB

Ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Ogerta Manastirliu mori pjesë në Sesionin e 66-të të Komisionit për Statusin e Gruas në Kombet e Bashkuara për "Arritjen e barazisë gjinore dhe fuqizimin e të gjitha grave dhe vajzave, në kuadër të ndryshimeve klimatike dhe politikave e programeve mjedisore, si edhe të atyre për uljen e rreziqeve nga fatkeqësitë", që zhvilloi punimet në New York. Në fjalën e saj, Manastirliu shprehu angazhimin e qeverisë shqiptare për të implementuar në të gjitha nivelet buxhetimin gjinor, në funksion të zbutjes së hendekut gjinor dhe fuqizimin e grave.